

Statistikat afatshkurtra

Tremujori II, 2016


Tiranë, më 29 Shtator: INSTAT publikon “Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike” për tremujorin e dytë 2016. Anketa mbulon aktivitetet: “Industri” (përfshirë Industri nxjerrëse dhe Industri përpunuese), “Energji elektrike, gaz, avull”, “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”, “Ndërtim”, dhe “Shërbime” (ku përfshihen Tregti, Transport dhe magazinim, Hotele, Informacion dhe komunikacion, Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, Agjenci udhëtimi). (Shih shënime metodologjike, fq.20).

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit, vlerësuar me çmime fikse (2010=100) arriti 118,3 në tremujorin e dytë 2016.

Ndryshimi vjetor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum pasqyron rritje prej 0,3 % në aktivitetet ekonomike të mbuluara në anketë, krahasuar me tremujorin e dytë 2015. Ky ndryshim në të njëjtin tremujor të vitit 2015 ishte me rritje 1,9 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e dytë 2016, paraqitet me rritje prej 10,1 % krahasuar me tremujorin e parë 2016.


Fig.1 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum



Për publikim 29/09/2016

Fig. 2 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në Industri, Ndërtim dhe Shërbime

(2010=100)



Tab. 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	Peshat	II - 15 II - 14	III - 15 III - 14	IV - 15 IV - 14	I - 16 I - 15	II - 16 II - 15
Aktivitetet ekonomike gjithsej		100,0	1,9	0,5	2,1	1,6	0,3
B+C	Industri	19,2	-4,7	-4,7	-4,4	-9,0	-16,9
B	Industri nxjerrëse	6,7	-34,6	-32,5	-37,2	-36,6	-36,0
C	Industri përpunuese	12,5	10,2	8,6	10,4	5,5	-6,8
D	Energji elektrike, gaz, avull	6,2	0,9	6,2	-4,5	1,5	-2,4
E	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizim me ujë	0,9	5,4	-0,6	6,2	-18,0	3,3
F	Ndërtim	10,6	11,8	10,7	14,5	5,3	2,9
G - N	Shërbime	63,0	2,4	-0,4	1,8	4,2	5,5
G	Tregti	55,3	5,9	1,6	3,2	3,0	4,5
H (49-53)	Transport dhe magazinim	1,7	-34,0	-36,4	-40,0	0,9	0,8
I (551)	Hotele	0,4	14,0	23,9	11,3	24,7	24,8
J (58-62)	Informacion dhe komunikacion	4,2	-21,0	-13,9	3,0	17,1	20,3
M (71)	Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	1,0	0,9	30,6	9,3	13,2	12,0
N (79)	Agjenci udhëtimi	0,5	11,0	20,5	21,8	6,9	3,0

Tab. 2 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	II -15 I - 15	III -15 II - 15	IV -15 III - 15	I -16 IV - 15	II -16 I - 16
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	11,4	7,6	3,7	-18,3	10,1
B+C	Industri	19,0	3,7	-6,3	-21,3	8,6
B	Industri nxjerrëse	8,5	0,9	-19,6	-28,1	9,6
C	Industri përpunuese	22,6	4,5	-2,3	-15,7	8,2
D	Energji elektrike, gaz, avull	-16,3	-3,9	13,0	11,7	-19,6
E	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	-9,8	-9,1	10,3	-9,3	13,5
F	Ndërtim	25,4	3,7	28,9	-37,2	22,5
G-N	Shërbime	10,9	11,1	0,6	-15,9	12,2
G	Tregti	11,6	9,5	0,4	-16,0	13,1
H (49-53)	Transport dhe magazinim	16,3	17,4	-13,5	-14,6	16,2
I (551)	Hotele	63,9	25,9	-20,0	-24,5	64,0
J (58-62)	Informacion dhe komunikacion	-2,0	25,0	10,4	-13,5	0,8
M (71)	Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	3,3	32,3	6,3	-22,1	2,2
N (79)	Agjenci udhëtimi	0,6	26,6	-0,3	-15,7	-3,2

Industri, Energji dhe Ujë

Në tremujorin e dytë 2016, **ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “*Industri*” (përfshirë *Industri nxjerrëse dhe përpunuese*) paraqet rënie 16,9 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015. Ndikimin kryesor e dha aktiviteti “*Industri nxjerrëse*” me një rënie prej 36,0 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, aktiviteti “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” paraqitet me rritje 3,3 % ndërsa aktiviteti “*Energji elektrike, gaz, avull*” paraqitet me rënie 2,4 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetin “*Industri*”, paraqet rritje 8,6 % krahasuar me tremujorin e parë 2016. Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht aktiviteti “*Industri përpunuese*” me 8,2 %.

Aktiviteti “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” paraqitet me rritje 13,5 % ndërsa aktiviteti “*Energji elektrike, gaz, avull*” paraqitet me rënie 19,6 %.

Krahasuar me tremujorin e dytë 2015, **ndryshimi vjetor** i volumit të prodhimit industrial në “*Industri*” shënoi një rënie prej 20,2 %. Ndikimin kryesor e dha aktiviteti “*Industri nxjerrëse*” me një rënie prej 30,5 %. Ndërkaq, aktiviteti “*Industri përpunuese*” shënoi rënie prej 5,6 % referuar të njëjtës periudhë krahasimore.

Gjatë tremujorit të dytë 2016, **ndryshimi tremujor** i volumit të prodhimit industrial shënoi rritje me 12,2 % krahasuar me tremujorin paraardhës, ku ndikimin më të madh e dha grupi “*Industri përpunuese*” me 16,9 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, volumi i prodhimit në aktivitetin “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” shënoi rritje prej 19,8 %, ndërsa aktiviteti “*Energji elektrike, gaz, avull*” shënoi rënie 14,1 %.

Ndryshimi vjetor i numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet që operojnë në aktivitetin “*Industri*” (*Industri nxjerrëse dhe përpunuese*), gjatë tremujorit të dytë 2016 paraqet rritje 7,9 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Ky tregues paraqitet me rritje edhe në aktivitetet “*Energji elektrike, gaz, avull*” me 2,4 % dhe “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” me 3,5 %.

Ndryshimi tremujor i numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e aktivitetit “*Industri*” paraqet rënie prej 0,2 %.

Gjatë tremujorit të dytë 2016, **ndryshimi vjetor** i nivelit të fondit të pagave shënoi një rritje prej 5,4 % në “Industri”, ndryshim i cili vjen kryesisht nga rënia e këtij treguesi në aktivitetin “Industri përpunuese” me 12,2 %.

Aktiviteti “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë” shënoi një rritje me 10,4 ndërsa aktiviteti “Energji elektrike, gaz, avull” paraqitet me rënie 5,3 %.

Ndryshimi tremujor i fondit të pagave shënoi rritje me 3,3 % në aktivitetin “Industri”, rritje e cila vjen kryesisht nga ndikimi i aktivitetit “Industri nxjerrëse” me 6,2 %

Fig. 3 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum dhe prodhimit industrial në volum në Industri nxjerrëse dhe përpunuese




Fig. 4 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në Industri nxjerrëse, Industri përpunuese, Energji Elektrike dhe Grumbullimi dhe furnizimi me ujë





Fig. 5 Sasia e prodhimit të Energjisë elektrike në (000/kw-orë)



Tab. 3 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
			II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
B-C	05-33	Industri	-4,7	-4,7	-4,4	-9,0	-16,9
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-34,6	-32,5	-37,2	-36,6	-36,0
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	10,2	8,6	10,4	5,5	-6,8
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	0,9	6,2	-4,5	1,5	-2,4
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	5,4	-0,6	6,2	-18,0	3,3

Tab. 4 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
			I - 15	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16
B-C	05-33	Industri	19,0	3,7	-6,3	-21,3	8,6
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	8,5	0,9	-19,6	-28,1	9,6
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	22,6	4,5	-2,3	-15,7	8,2
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	-16,3	-3,9	13,0	11,7	-19,6
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	-9,8	-9,1	10,3	-9,3	13,5

Tab. 5 Ndryshimi vjetor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
			II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
B-C	05-33	Industri	-4,9	-2,9	-6,6	-18,5	-20,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-23,8	-27,1	-27,5	-39,4	-35,0
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	14,2	23,0	13,4	3,8	-5,6
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	19,1	-27,9	-12,7	35,7	17,8
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	1,6	-3,3	-2,3	-23,9	8,9

Tab. 6 Ndryshimi tremujor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
			I - 15	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16
B-C	05-33	Industri	14,5	10,3	-12,6	-26,3	12,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-1,3	7,7	-19,0	-29,6	5,8
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	28,6	12,2	-8,4	-21,4	16,9
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	-1,1	-66,1	79,9	124,8	-14,1
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	-16,3	-5,5	2,9	-6,4	19,8

Tab. 7 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
			II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
B-C	05-33	Industri	3,8	7,4	12,3	8,0	7,9
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	3,3	-2,3	-2,3	-7,5	-10,2
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	4,0	9,0	14,8	10,6	10,9
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	12,2	14,6	14,2	8,8	2,4
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	15,2	15,3	21,0	8,7	3,5

Tab. 8 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
			I - 15	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16
B-C	05-33	Industri	-0,1	3,8	3,8	0,4	-0,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-1,5	3,5	-0,3	-9,0	-4,4
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	0,1	3,8	4,5	1,8	0,4
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	5,1	1,0	1,4	1,1	-1,2
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	0,3	-0,7	2,1	7,0	-4,5

Tab. 9 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
			II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
B-C	05-33	Industri	4,2	4,3	4,2	-0,1	5,4
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-1,9	-9,4	-19,2	-19,3	-7,0
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	7,0	11,1	16,1	10,7	12,2
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	1,3	1,3	-1,2	-5,9	-5,3
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	0,4	9,1	12,5	13,1	10,4

Tab. 10 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
			I - 15	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16
B-C	05-33	Industri	-2,1	2,1	2,4	-2,4	3,3
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-7,9	-0,7	-7,8	-4,5	6,2
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	0,5	3,3	6,5	0,1	1,9
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	-4,3	-2,9	0,6	0,7	-3,7
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	4,0	1,8	1,6	5,2	1,5


Grupimet industriale kryesore

Ndryshimi vjetor i indeksit të shifrës së afarizmit sipas Grupimeve industriale kryesore, në tremujorin e dytë 2016 pasqyron rritje në grupimet “Mallra të paqëndrueshme konsumi” me 8,0 % dhe “Mallra kapitale” me 3,2 %. Për sa i përket këtij treguesi, me rënie paraqiten tre grupimet e tjera si “Mallra të ndërmjetme” me 22,9 %, “Energji” me 19,5 % dhe “Mallra të qëndrueshme konsumi” me 1,8 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit sipas Grupimeve industriale kryesore, në tremujorin e dytë 2016 pasqyron rritje në grupimet “Mallra konsumi të qëndrueshme” me 20,6 %, “Mallra kapitale” me 15,6 %, “Mallra të ndërmjetme” me 13,5 % dhe “Mallra konsumi të paqëndrueshme” me 6,4 %. Ndërsa referuar të njëjtës periudhë krahasimore, i vetmi grupim industrial që paraqitet me rënie është “Energjia” me 9,6 %.

Fig. 6 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum sipas Grupimeve Industriale Kryesore

(2010=100)



Tab. 11 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit sipas Grupimeve industriale kryesore

(%)

Grupimet industriale kryesore	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
<i>Mallra të ndërmjetme</i>	-2,6	-10,0	-13,4	-19,9	-22,9
<i>Energji</i>	-14,8	-13,9	-16,2	-17,9	-19,5
Mallra kapitale	16,9	18,1	16,6	20,5	3,2
Mallra të qëndrueshme konsumi	23,1	-0,5	2,4	14,5	-1,8
Mallra të paqëndrueshme konsumi	7,3	17,6	25,7	16,8	8,0

Tab. 12 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit sipas Grupimeve industriale kryesore

(%)

Grupimet industriale kryesore	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
	I - 15	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16
<i>Mallra të ndërmjetme</i>	17,9	-5,0	-4,5	-25,1	13,5
<i>Energji</i>	-7,8	-4,9	2,1	-8,3	-9,6
Mallra kapitale	35,1	8,8	12,6	-27,2	15,6
Mallra konsumi të qëndrueshme	40,6	-3,2	18,2	-28,8	20,6
Mallra konsumi të paqëndrueshme	15,1	18,3	-5,5	-9,2	6,4

Ndërtimi


Në aktivitetin “Ndërtim”, **ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e dytë 2016 paraqet rritje prej 2,9 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015. Volumi i ndërtimit paraqet rritje prej 1,0 % krahasuar me të njëjtën periudhë.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Ndërtim” në tremujorin e dytë 2016 paraqet rritje prej 4,2 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015, shoqëruar me rritje të fondit të pagave, prej 1,1 % gjatë së njëjtës periudhë.

Në tremujorin e dytë 2016, **ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, paraqet rritje prej 22,5 % krahasuar me tremujorin e parë 2016, ndërkaq volumi i ndërtimit është rritu me 25,7 % gjatë së njëjtës periudhë.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Ndërtim” në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e parë 2016, shënoi rritje prej 0,2 %, ndërkaq fondi i pagave shënoi rritje prej 0,4 %.

Fig. 7 Indekset e shifrës së afarizmit në volum dhe volumit të ndërtimit



Tab. 13 Ndryshimi vjetor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(%)


NVE Rev.2	Treguesit	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
		II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
41-43	Shifra e afarizmit	11,8	10,7	14,5	5,3	2,9
	Volumi i ndërtimit	22,7	14,5	22,2	2,7	1,0
	Të punësuar me pagesë	14,1	8,9	12,5	8,0	4,2
	Fondi i pagave	20,0	15,3	10,1	8,6	1,1

Tab. 14 Ndryshimi tremujor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(%)

NVE Rev.2	Treguesit	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
		I - 15	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16
41-43	Shifra e afarizmit	25,4	3,7	28,9	-37,2	22,5
	Volumi i ndërtimit	27,8	1,9	31,7	-40,2	25,7
	Të punësuar me pagesë	3,9	0,1	6,9	-2,9	0,2
	Fondi i pagave	7,8	-0,6	2,4	-1,1	0,4

Fig. 8 Indeksi i volumit të ndërtimit në Ndërtime të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike



Shërbime

Në tremujorin e dytë 2016, **ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në ndërmarrjet që operojnë në “*Shërbime*” shënoi rritje me 5,5 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015, ndikuar kryesisht nga aktiviteti “*Hotele*” me 24,8 % dhe pasuar nga “*Informacion dhe komunikim*” me 20,3 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “*Shërbime*” në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e parë 2016, është rritur 12,2 %. Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht aktiviteti “*Hotele*” me 64,0 %.

Në aktivitetin “*Shërbime*”, në tremujorin e dytë 2016, ka një rritje të numrit të të punësuarve me pagesë me 9,9 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Këtë rritje e kanë dhënë kryesisht aktivitetet “*Transport dhe magazinim*” me 11,5 % dhe “*Tregti*” me 11,2 %.

Ndryshimi tremujor në ndërmarrjet që operojnë në “*Shërbime*”, në tremujorin e dytë 2016, paraqet rënie të numrit të të punësuarve me pagesë me 2,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016. Në këtë rënie kanë ndikuar negativisht aktiviteti “*Tregti*” me 4,8 % dhe pozitivisht aktivitetet “*Informacion dhe komunikim*” dhe “*Transport dhe magazinim*” respektivisht me 2,7 dhe 2,6 %.

Në aktivitetin “*Shërbime*”, **ndryshimi vjetor**, në tremujorin e dytë 2016, paraqet një rritje të fondit të pagave me 9,7 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht aktiviteti “*Agjenci udhëtimi*” me 33,9 %.

Ndryshimi tremujor i fondit të pagave në këtë aktivitet paraqitet me rritje 0,8 % në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e parë 2016. Në këtë rritje kanë ndikuar kryesisht aktivitetet “*Tregti me shumicë*” me 5,9 % dhe “*Agjenci udhëtimi*” me 4,0 %.

Tregtia me shumicë dhe Tregtia me pakicë e shumicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave

Ndryshimi vjetor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e dytë 2015, në aktivitetet “*Tregti me pakicë dhe shumicë dhe riparimi i automjeteve e motoçikletave*” paraqet rritje me 14,6 %, ndërkaq “*Tregti me shumicë*” paraqet rritje me 3,4 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetin “*Tregti me shumicë*” paraqitet me rritje 15,2 %, ndërkaq aktiviteti “*Tregti me pakicë dhe shumicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave*” paraqet një rritje 5,0 % në tremujorin e dytë 2016 në krahasim me tremujorin parë 2016.

Në tremujorin e dytë 2016, në ndërmarrjet që operojnë në aktivitetin “*Tregti me shumicë*”, **ndryshimi vjetor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë paraqet rritje 10,1 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Ndryshimi tremujor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “*Tregti me shumicë*” paraqet një rritje me 3,3 %.

Në aktivitetin “*Tregti me shumicë*”, **ndryshimi vjetor**, në tremujorin e dytë 2016 paraqet një rritje të fondit të pagave me 19,3 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërkaq në aktivitetin “*Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve*” rritje me 16,3 %.

Në ndryshim tremujor, ky tregues paraqet rritje 5,9 % në aktivitetin “*Tregti me shumicë*”, ndërkaq në aktivitetin “*Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve*” ka pasur rritje me 1,1 % krahasuar me tremujorin e parë 2016.

Transport dhe Magazinin (përfshirë dhe aktiviteti “Postë”)

Në aktivitetin “*Transport dhe magazinim*”, shifra e afarizmit në volum ka shënuar rritje me 0,8 %, në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet “*Transport dhe magazinim*” ka shënuar rritje 16,2 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “*Transport dhe magazinim*” paraqet një rritje me 11,5 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Ndryshimi tremujor i këtij treguesi në aktivitetin “*Transport dhe magazinim*” shënoi një rritje me 2,6 % krahasuar me tremujorin e parë 2016.

Referuar të njëjtit aktivitet, **ndryshimi vjetor** i indeksit të fondit të pagave paraqet një rritje me 2,7 %.

Krahasuar me tremujorin e parë 2016, indeksi i fondit të pagave në aktivitetin “*Transport dhe magazinim*” paraqitet me ulje 0,3 %.

Hotele

Në aktivitetin “*Hotele*”, **ndryshimi vjetor** i shifrës së afarizmit në volum, paraqet rritje me 24,8 % në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Në tremujorin e dytë 2016, në aktivitetin “*Hotele*”, krahasuar me tremujorin e parë 2016, indeksi i shifrës së afarizmit në volum paraqet rënie 64,0 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në tremujorin e dytë 2016 paraqet rritje 8,1 %, ndërsa **ndryshimi tremujor**, krahasuar me tremujorin e parë 2016, i këtij treguesi paraqet rritje 5,2 %.

Ndryshimi vjetor i fondit të pagave në ndërmarrjet e aktivitetit “*Hotele*” paraqet rritje 7,5 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015, ndërsa **ndryshimi tremujor** i këtij treguesi, krahasuar me tremujorin e parë 2016, paraqet rritje 2,0 %.

Informacioni dhe Komunikimi

Në aktivitetin “*Informacioni dhe Komunikimi*”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum ka një rritje prej 20,3 % në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “*Informacioni dhe Komunikimi*” paraqet rritje 0,8 % krahasuar me tremujorin e parë 2015.

Në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e dytë 2015, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë, në aktivitetin “*Informacioni dhe Komunikimi*”, paraqitet me rritje 8,0 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë referuar të njëjtit aktivitet paraqet rritje 2,7 %.

Fondi i pagave në aktivitetin “*Informacioni dhe komunikimi*” paraqitet me rënie 4,6 % në tremujorin dytë 2016 krahasuar me tremujorin e dytë 2015, ndërsa **ndryshimi tremujor** i indeksit të fondit të pagave paraqet rënie 0,7 % në krahasim me tremujorin e parë 2016.

Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike

Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në “*Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike*” u rrit me 12,0 % në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum paraqet rritje me 2,2 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “*Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike*” paraqet rritje 9,2 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2015, ndërsa në **ndryshim tremujor**, referuar të njëjtit aktivitet, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë paraqitet me rritje 3,4 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të fondit të pagave në aktivitetin “*Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike*” paraqet rritje me 5,3 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Ndryshimi tremujor i indeksit të fondit të pagave në këtë tremujor, referuar të njëjtit aktivitet paraqet një rënie me 0,8 %.

Agjenci udhëtimi

Në aktivitetin “*Agjenci udhëtimi*”, shifra e afarizmit në volum u rrit me 3,0 % në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e dytë 2015.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum paraqet rënie 3,2 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “*Agjenci udhëtimi*” paraqet rritje 20,6 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015, ndërkaq **në ndryshim tremujor**, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në këtë aktivitet paraqitet me rritje 8,8 % krahasuar me tremujorin e parë 2016.

Indeksi i fondit të pagave, **në ndryshim vjetor**, në aktivitetin “*Agjenci udhëtimi*” paraqitet me rritje 33,9 % krahasuar me tremujorin e dytë 2015, ndërkaq **në ndryshim tremujor**, ky tregues paraqitet me rritje 4,0 % krahasuar me tremujorin e parë 2016.

Tab. 15 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime (%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15 II - 14	III - 15 III - 14	IV - 15 IV - 14	I - 16 I - 15	II - 16 II - 15
G-N	Shërbime	2,4	-0,4	1,8	4,2	5,5
G(45)	<i>Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave</i>	6,7	4,3	26,1	12,7	14,6
G(46)	<i>Tregtia me shumicë</i>	6,6	-0,6	0,9	1,9	3,4
H(49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	-34,0	-36,4	-40,0	0,9	0,8
I(551)	<i>Hotele</i>	14,0	23,9	11,3	24,7	24,8
J(58, 61, 62)	<i>Informacioni dhe komunikimi</i>	-21,0	-13,9	3,0	17,1	20,3
M(71)	<i>Aktivite arkitekture dhe inxhinierike</i>	0,9	30,6	9,3	13,2	12,0
N(79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	11,0	20,5	21,8	6,9	3,0

Tab. 16 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
		I - 15	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16
G-N	Shërbime	10,9	11,1	0,6	-15,9	12,2
G(45)	<i>Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave</i>	3,2	6,6	20,2	-14,8	5,0
G(46)	<i>Tregtia me shumicë</i>	13,5	8,4	-0,7	-16,6	15,2
H(49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	16,3	17,4	-13,3	-14,4	16,2
I(551)	<i>Hotele</i>	63,9	25,9	-20,0	-24,5	64,0
J(58, 61, 62)	<i>Informacioni dhe komunikimi</i>	-2,0	25,0	10,4	-13,5	0,8
M(71)	<i>Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike</i>	3,3	32,3	6,3	-22,1	2,2
N(79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	0,6	26,6	-0,3	-15,7	-3,2

Tab. 17 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
		II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
G-N	Shërbime	7,3	14,6	16,2	13,5	9,9
G(45)	<i>Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave</i>	5,8	24,8	18,9	7,8	10,4
G(46)	<i>Tregtia me shumicë</i>	20,3	18,5	19,1	5,8	10,1
H(49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	-1,2	-1,1	-0,6	10,7	11,5
I(551)	<i>Hotele</i>	11,7	15,8	11,5	11,7	8,1
J(58, 61, 62)	<i>Informacioni dhe komunikimi</i>	7,0	9,1	17,2	10,6	8,0
M(71)	<i>Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike</i>	-0,2	11,8	14,2	6,8	9,2
N(79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	22,2	27,5	22,0	27,8	20,6

Tab. 18 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16	II - 16
		I - 15	II - 15	III - 15	IV - 15	I - 16
G-N	Shërbime	0,6	3,1	1,8	7,5	-2,6
G(45)	<i>Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave</i>	-1,5	4,1	2,2	2,9	0,9
G(46)	<i>Tregtia me shumicë</i>	-0,8	2,5	0,6	3,4	3,3
H(49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	1,8	1,3	0,6	6,7	2,6
I(551)	<i>Hotele</i>	8,6	16,2	-10,0	-1,7	5,2
J(58, 61, 62)	<i>Informacioni dhe komunikimi</i>	5,2	1,4	2,7	0,9	2,7
M(71)	<i>Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike</i>	1,2	0,8	11,6	-6,2	3,4
N(79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	15,3	6,4	-3,4	7,8	8,8

Tab. 19 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15 II - 14	III - 15 III - 14	IV - 15 IV - 14	I - 16 I - 15	II - 16 II - 15
G-N	Shërbime	7,5	12,3	10,8	10,4	9,7
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	2,0	16,5	15,0	14,2	16,3
G(46)	Tregtia me shumicë	14,9	13,7	18,0	13,0	19,3
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-20,9	-13,5	-13,3	4,9	2,7
I(551)	Hotele	12,8	13,3	6,9	13,9	7,5
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikimi	16,1	12,6	-0,1	-1,3	-4,6
M(71)	Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike	18,0	19,2	19,3	4,8	5,3
N(79)	Agjenci udhëtimi	20,3	27,7	17,3	38,0	33,9

(%)

Tab. 20 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 15 I - 15	III - 15 II - 15	IV - 15 III - 15	I - 16 IV - 15	II - 16 I - 16
G-N	Shërbime	1,4	0,3	2,6	5,8	0,8
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	-0,7	5,0	3,9	5,5	1,1
G(46)	Tregtia me shumicë	0,3	-0,4	3,3	9,5	5,9
H(49-53)	Transport dhe magazinim	1,7	3,6	1,6	-2,2	-0,3
I(551)	Hotele	8,1	13,4	-10,8	4,2	2,0
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikimi	2,7	-9,1	3,7	1,9	-0,7
M(71)	Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike	-1,2	1,2	4,0	0,8	-0,8
N(79)	Agjenci udhëtimi	7,2	8,2	-0,4	19,5	4,0

Metodologjia

Informacion

INSTAT si rrjedhojë e detyrimeve që ka ndaj Eurostat, për përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato të vendeve Europiane, publikon indekset e treguesve ekonomike si Shifër afarizmi, Prodhim, Numri i të punësuarve me pagesë dhe Paga për aktivitetet Industri, (ku përfshihen Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, gaz, avull; Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë; Ndërtim si dhe Shërbime, ku përfshihen (Tregti; Transport dhe magazinim; Hotele; Informacioni dhe komunikacioni; Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi).

Në Tregti, anketa mbulon aktivitetet Tregti me pakicë dhe shumicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe Tregti me shumicë. Treguesit e Tregtisë me pakicë publikohen më vete. Për më shumë informacion, linku: <http://www.instat.gov.al/al/themes/informacioni-ekonomik-për-ndërmarrjet/publication/books/2014/tregtia-me-pakicë,-t3-2014.aspx>;

Ndryshimet metodologjike i referohen:

- Aplikimit të Nomenklaturës së rishikuar të aktiviteteve ekonomike, NVE Rev.2;
- Ri-peshimit, përditësohen peshat e përfaqësimit, nga ASN 2005 në ASN 2010 deri në vitin 2013. Sipas rekomandimeve të Eurostat-it dhe asistencës Suedeze është bërë përditësimi i peshava për vitin 2015 duke përdorur peshat ASN 2013, (t-2) sipas metodës Chain-link.
- Ri-referimit, përditësohet periudha referuese nga 2005=100 në 2010=100;

Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014.

Për më shumë shikoni linkun: http://www.instat.gov.al/media/248316/njoftim_per_media_-_ndryshimi_i_nomenklatur_s_s_veprimtarive_ekonomike_rev_2.pdf

Klasifikimi i rishikuar është në mënyrë të konsiderueshme i ndryshëm nga klasifikimi ekzistues në drejtim të strukturës, klasifikimit dhe trajtimit metodologjik të disa aktiviteteve.

Kalimi i njërive statistikore nga NVE Rev.1.1 në NVE Rev.2 është bërë nëpërmjet ndërtimit të matricës së konvertuar, bazuar në informacionin statistikor të përfutur nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2010.

Referuar pikërisht kësaj matrice, disa nga grup-aktivitetet që janë publikuar me NVE Rev.1.1 përgjithësisht kalojnë 100 përqind në grup aktivitete publikimi në NVE Rev.2. Ndryshimet që kryesisht sjellë klasifikimi i ri për aktivitetet përbërëse të fushës së mbulimit të ATN, janë si më poshtë:

- a. Sipas klasifikimit të vjetër (NVE Rev. 1) aktivitetet e “Publikimit” përkojnë me ndarjen 22. Në klasifikimin e ri (NVE Rev. 2) “Aktivitete publikimi” përkon me ndarjen 58, seksioni J, “Informacioni dhe Komunikacioni”.
- b. Ndarja 45, që përkon me NVE Rev.1.1 në aktivitetin e “Ndërtimit”, detajohet në tre ndarje në klasifikimin e ri, në 41, “Ndërtimi i ndërtesave”, 42, “Punime inxhinierike” dhe 43 “Punime të specializuara ndërtimi”. Pjesë e ndarjes 41 bëhet edhe grupi 70.1 që përkon në NVE Rev.1.1, me aktivitetin “Aktivitete mbi pasuritë e patundshme”.
- c. Aktivitetet e postave dhe korrierës, që përkon në NVE Rev. 1.1, me klasat 64.11 dhe 64.12, kalon në aktivitetin “Transport dhe magazinim”, që përkon në NVE Rev.2 me ndarjen 58, “Aktiviteti i postës dhe korrierës”.
- d. Një tjetër risi e klasifikimit të ri, me ndikim në publikimin e indeksit të statistikave afatshkurtra (tremujore) është edhe ardhja në fushën e mbulimit të aktiviteteve si: “Grumbullimi dhe Trajtimi i mbeturinave”, që përkon me klasifikimin NVE Rev.1.1, ndarja 90. Në klasifikimin e ri, NVE Rev.2, këto aktivitete i përkojnë ndarjes 38, “Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve”. Bëhet pjesë e kësaj ndarje edhe grupi 38.3, që përkon në NVE Rev.1.1, me ndarjen 37, “Riciklimi”.
- e. Në grupin 71.00, që përkon në NVE Rev.2, me “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike”, përfshihen edhe aktivitete të veçanta të grupeve 74.3 -74.8, që përkon me NVE Rev.1.1 me “Aktivitete të kontrollit dhe analiza teknike”.

Treguesi kryesor i shifrës së afarizmit është përdorur për rivlerësimin e kalimit të aktiviteteve ekonomike nga nomenkatura e vjetër në nomenklaturën e re. Metodatat kryesore të përdorura për vlerësim janë dy:

- Metoda e vlerësimit në nivel mikro
- Metoda e vlerësimit në nivel makro

Metoda e parë, u përdor për tre vitet e para të riklasifikimit të aktiviteteve të njëjësive në nivel individual në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, 2010-2012;

Metoda e dytë, u përdor për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore pas, për periudhën 2005-2010.

Ri-peshimi – për reflektuar ndryshimet e strukturës së ekonomisë, peshat përditësohen, sipas metodologjisë së statistikave europiane sipas aktiviteteve përfaqësuese, nga 2005 në 2010.

Ri –referim - shprehimisht do të thotë kalimi i indekseve me një periudhë referuese të re, nga 2005=100 në 2010=100. Seritë e të dhënave, të llogaritura me të dy periudhat, janë ekuivalente me njëra-tjetrën: ritmet e rritjes janë të njëjta, dhe një seri mund të konvertohet tek tjetra.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike (35)
- Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë (36)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Shërbime, të cilat përbëhen nga Tregtia me shumicë, Hotele, Transport dhe Magazinim, Agjenci udhëtimi, Komunikacion dhe Informacion dhe shërbime të tjera:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor, përfshi vetëm Hotele (55.1)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për aktivitetin hotelier, si dhe Shitjen dhe riparimin e automjeteve. Për aktivitetet e transportit përdoret deflator i llogaritur në mënyrë implicite nga të dhënat administrative. Indekset nuk janë të vlerësuara sezonalisht.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shifra e afarizmit - Shifra e afarizmit përfshin shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shifrës së afarizmit - Objektivi i indeksit të shifrës së afarizmit është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

Numri i të punësuarve me pagesë - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

Indeksi i Numrit të punësuarve me pagesë - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojuara.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Grupimet Industriale Kryesore janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> • 07-09 Nxjerrja e mineraleve natyrore; Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare • 13000 Përpunimi i tekstileve • 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve • 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre • 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike • 22000 Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës • 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike • 24000 Metalurgjia • 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve • 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike
Energji	<ul style="list-style-type: none"> • 05-06 Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror • 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës • 35000 Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri i kondicionuar
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> • 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore • 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike • 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t • 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> • 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët • 31000 Prodhimi i mobiljeve • 32XXX Industri të tjera p.k.t
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> • 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore • 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit • 14000 Konfeksionimi i veshjeve • 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure • 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara • 32YYY Industri të tjera p.k.t

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres.

Shpërndarja e peshave sipas Grupimeve Industriale Kryesore:

Grupimet Industriale Kryesore	Peshat sipas aktiviteteve (Shitjet neto)
Mallra të ndërmjetme	27 %
Energji	42 %
Mallra kapitale	3 %
Mallra konsumi të qëndrueshme	3 %
Mallra konsumi të paqëndrueshme	25 %
Totali	100 %